



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 115

Prishtinë, më 3.6.2013, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Liburn Aliu, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Nijazi Idrizi, Boban Todorović.

Munguan : Rasim Demiri, Salih Morina, Daut Haradinaj.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: sipas listës së nënshkruar nga pjesëmarrësit.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi dhe Flaka Broqi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës ;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 24.5.2013,
3. Shqyrtimi i vërejtjeve me MMPH në Projektligjin për Shfrytëzimin, Administrimin dhe Mirëmbajtjen e Ndërtesave në Bashkëpronësi,
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime dhe u shtua për “Të ndryshme” shqyrtimi i kërkesës së UNDP për mbështetje me ekspert për fushën e komisionit dhe kërkesa e ndërtimtarëve për rishikimin e UA për licencim.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 24.5.2013

Kryetari i Komisionit konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 24.5.2013.

3. Shqyrtimi i projektligjit për ndërtesat në bashkëpronësi

Kryetari Nait Hasani përshëndeti të pranishmit dhe kërkoi që përfundimisht të shqyrtohen vërejtjet dhe sugjerimet për këtë projektligj duke marr parasysh komentet nga MMPH por edhe të projektit në krye me Bill Donovan. Gjatë shqyrtimit dhe komenteve të bëra komisioni nuk arriti të përfundoi konstatimet rreth këtij projektligji, ndaj u angazhuan zyrtarët e MMPH dhe zyrtari Amerikan të gjejnë zgjidhje të përbashkët lidhur me çështjet kontestuese.

4. Të ndryshme

1. Komisioni konstatoi se kërkesa e UNDP për të miratuar mbështetjen e ekspertit për fushën e këtij komisioni është e arsyeshme duke pasur parasysh vështirësitë financiare në Kuvend lidhur me financimin e ekspertëve, ndaj nxori :

P Ë R F U N D I M

Të angazhohet eksperti Blerim Vela i cili do të kompensohet nga UNDP për fushën e Komisionit për Bujqësi dhe Mjedis për afatin 6 (gjashtë) mujor, pasi të kryhen formalitetet në Sekretarinë e Kuvendit.

2. Lidhur me kërkesën e disa shoqatave të ndërtimtarëve të cilën e parashtrori deputetja **Sevdije Lama** e cila sqaroi se në bazë të Ligjit për ndërtimin është nxjerr UA nr.20/2010 dhe 06/2011 me të cilat inxhinierëve të diplomuar të arkitekturës dhe inxhinierëve të diplomuar të ndërtimtarisë ju kërkohet prapë të japin provimin profesional si parakusht për dhënien e licencave për ushtrimin e veprimtarive profesionale nga fushat përkatëse, ndaj Komisioni u pajtua që të drejtohet ministrisë përkatëse , si vijon :

P Ë R F U N D I M

KËRKOHET nga MMPH të sqaroi Udhëzimet Administrative UA nr. 20/2010 dhe UA 06/2011 për dhënien e licencave, të nxjerura në bazë të Ligjit për ndërtimin, lidhur me kushtet e caktuara për dhënien e licencave, sidomos për faktin pse inxhinierët përkatës duhet prapë të kalojnë provimin profesional si parakusht për dhënien e licencave.

Mbledhja përfundoi në orën 15,00.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani

